



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 25.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 19.08.2025 të parashtruar nga operatori ekonomik **INFINITTSH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Furnizim me pajisje për klimatizim për nevojat e MSH-së dhe ISSH-së”** me nr. prokurimi 206-25-4764-1-2-1, Nxjerr:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e INFINITT SH.P.K. e datës 19.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me pajisje për klimatizim për nevojat e MSH-së dhe ISSH-së”** me nr. prokurimi 206-25-4764-1-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, të datës 14.08.2025 te publikuar ne platformën elektronike.
- II. **Anulohet**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 14.08.2025;
- III. Autoriteti Kontraktues, e kthen ne Rivleresim aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik INFINITT SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim per AP me titull **“Furnizim me pajisje për klimatizim për nevojat e MSH-së dhe ISSH-së”** me nr. prokurimi 206-25-4764-1-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 25.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1- Qellimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 52- Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
Neni 59- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60- Kriteret për dhenie të kontratës
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 10.1 I UOPP-se Sqarimi I tendereve
Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve.

Pretendimet Ankimore të OE ankues:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ dhe rregulloren për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me 14.08. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë OE Astech sh.p.k. për 2 lotet.

Qasje në dokumente zyrtare kemi kërkuar me 14.08. dhe me 15.08. AK na ka ofruar qasjen sipas kërkesës sone.

Në bazë të dokumenteve të cilat kemi pranuar në qasje në dokumente zyrtare konstatojmë se AK ka rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm për 2 lotet.

Kriteri nr.2 lidhur me kapacitetin teknik&profesional në dosjen e tenderit i parashtruar nga AK është:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përputhshmëri me specifikimet teknike, si dhe të bashkëngjisë katalogun zyrtar të prodhuesit për secilin artikull të ofruar, ku duhet të jenë nënvizuar qartë specifikat teknike të produktit që ofrohet.

Dëshmia 2 – Deklarata për përputhshmëri me specifikimet teknike për mallrat e ofruara; – Katalogu zyrtar i prodhuesit për secilin artikull të ofruar, me specifikat teknike të theksuara.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një katalog të përgaditur nga OE ku nuk është cekur prodhuesi brendi si dhe nuk dihet autenticiteti i katalogut të cilin ka dorëzuar OE në këtë mënyrë është dashur të eliminohet si i papërgjegjshëm.

Komisioni vlerësues nuk është dashur të mëre si të mirëqene katalogun e dorëzuar nga OE Astech sh.p.k. pasi që nuk i ka të dhënat bazike emrin e prodhuesit dhe modelin katalogu nuk është i leshuar nga prodhuesi. OE ka vënë në lajthitje komisionin pasi që ka përgaditur një file me të dhënat teknike të cilat nuk mund të verifikohen a janë autentike dhe nuk dihet cilit model- klime i takojnë.

Në anën tjetër kompania jone është eliminuar megjithatë kemi plotësuar të gjitha kërkesat/kriteret e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kompania jone është eliminuar me arsyejen, citoj:

Mospërmbyllja e Kriterit 24 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përputhshmëri me specifikimet teknike, si dhe të bashkëngjisë katalogun

zyrtar të prodhuesit për secilin artikull të ofruar, ku duhet të jenë nënvizuar gartë specifikat teknike të produktit që ofrohet- Operatori ekonomik <INFINITT= SH.P.K ka dorëzuar deklaratën për përputhshmëri me specifikimet teknike, por nuk ka ofruar katalogë zyrtarë të prodhuesit me specifika të nënvizuara. Në vend të katalogëve, operatori ka paraqitur dy dokumente me titull:

e 12K ERP Test Report 4 TAC-12CHSDTPG3113A, dhe

e 18K ERP Test Report 4-TAC-18CHSDTPG3113A.

Këto dokumente përfaqësojnë raporte testimi (ERP test reports) dhe nuk përmbajnë specifikime të nënvizuara qartë siç është kërkuar, **si dhe nuk janë katalogë zyrtarë të prodhuesit, siç kërkohet në mënyrë eksplicite në Kriterit 24 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Për**

Ne nuk kemi dorëzuar katalogun për shkak të një gabimi teknik në ofertim, mirëpo kemi dorëzuar dokumentin autentik nga prodhuesi TCL / Specifikimet teknike ku në faqe 2,3,8-14 janë paraqitur specifikimet teknike të klimave të ofrtuara të brendit TCL.

Perkunder që kompania jone ka dorëzuar specifikimet teknike, duke u mbështetur në nenin 72.3 të LPP-se dhe nenin 10.1 të UOPP-se AK ka mund të kërkojë sqarime shtesë katalogun e produkteve, citoj:

Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu

Mund të kërkojnë informata sqaruese

69

AK fare pa shtjerrur mundësitë ligjore dhe duke mos pasur parasysh nenin 1 të LPP-se kur dihet që Qellimi i këtij ligji është që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale dhe ekonomike, kalon të OE i renditur i katërti i cili rezultoi i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar katalogun autentik nga prodhuesi.

Pasqë për një situatë të njëjtë kemi dorëzuar ankese në OSHP citojmë vendimin nr. 2025/385 ku eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues ka konkluduar se pasqë OE ka dorëzuar deklaratën për specifikime teknike AK është dashur të kërkojë sqarime shtesë katalogun konfirm dispozitave ligjore të lartecëkura.

Më parasysh faktet e lartecëkura konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka vepruar jashtëligjshëm kur ka vendosur të rekomandojë për kontratë OE të papërgjegjshëm për 2 lotet në këto aktivitete të prokurimit prandaj kërkojmë që të aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim si e bazuar dhe lenda të kthehet në ri-vlerësim, ri-vlerësimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat/kriteret e përcaktuara nga AK në dosjen e tenderit.

Dëmet materiale sipas OE ankues:

Si pasoje e shkeljeve të lartecëkura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhë deri tek dhenia e kontratës për OE të papërgjegjshëm për 2 lotet në këto mënyra na është mohuar fitimi simbolik i paramanduar nga kjo kontratë dhe nuk është respektuar neni 60 i LPP-se që kontrata të ipet kompanisë sone si tenderi i përgjegjshëm me cmimin me të ulët.

Poashtu shpërblimi me kontratë për OE me cmim me të lartë demton buxhetin publik përkatesisht MSH-se për 3075.00euro.

Kërkojmë nga zyrtari përgjegjës i prokurimit që pas shoshitjes së provave dhe fakteve të aprovojë ankesën (kërkesën për ri-shqyrtim) si të bazuar, lenda të kthehet në ri-vlerësim në të kundërtën jemi të obliguar të dorëzojmë ankese në OSHP.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore te OE ankues:

Komisioni vleresues gjate vleresimit te tenderit, ka bere hulumtim ne internet per produktet e ofruara dhe pas hulumtimit ne internet ka ardhur ne perfundim se oferta e OE te rekomanduar i ka plotesuar specifikat e kerkuara, bazuar ne Deklaraten per specifikacion, broshuren e ofruar, si dhe emrin e prodhuesit Toyotomi/ KINE ne Pershkrimin e Çmimeve.

Konsiderojmë se pretendimet e juaja ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe në baze të pretendimeve ankimore, ZPP i AK-MSh e konsideron të nevojshme që lënda të kthehet në rivlerësim, meqenëse sikur OE ankues edhe OE i rekomanduar nuk e kanë ofruar katalogun siç është kërkuar në NJK dhe DT dhe komisioni gjatë rivlerësimit mund të kërkojë sqarime shtesë siç e parasheh legjislacioni në fuqi:


UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit